

Vendim nr. 316 datë 26.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marjana Semini, Anëtare
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 26.12.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 18 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SPARTAK QIRJAQI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 84, datë 13.03.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 66, datë 28.04.2023 të Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2024-1531, datë 24.09.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 42, 43, 122, pika 2, 124, pika 1, 142, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 27, 71, pikat 1 dhe 2, 71/a, pika 1, shkronja “b”, 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Spartak Qirjaqi në datën 01.02.2023 ka paraqitur në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) kallëzim për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*KP*), ndaj një prokurori të Prokurorisë së Posaçme, me argumentin se i kallëzuari e ka penguar të paraqesë kallëzim ndaj një grupi të strukturuar kriminal, pjesë e të cilit, sipas kërkuesit, ishin një prokuror tjetër dhe disa punonjës të Policisë së Shtetit. Sipas kërkuesit, ai ka qenë viktimë e disa veprave penale në vitin 2012, të cilat nuk i ka kallëzuar në kohën e duhur, sepse nuk kishte besim tek organet e drejtësisë. Po ashtu, kallëzuesi parashtron se procedimi penal nuk ka qenë i suksesshëm për shkak të veprimeve të paligjshme të grupit të strukturuar kriminal dhe të prokurorit të kallëzuar, si pasojë e të cilave veprat penale në dëm të kërkuesit janë parashkruar.

2. Në datën 13.02.2023 Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se nuk ka elemente të veprës penale. Kërkuesi ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*). Kjo e fundit, me vendimin nr. 84, datë 13.03.2023, ka vendosur rrëzimin e ankimit, me arsyetimin se në veprimet dhe mosveprimet e prokurorit të kallëzuar nuk konstatohet paligjshmëri e për rrjedhojë nuk plotësohet asnjë prej elementeve të anës objektive të veprës penale. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është miratuar nga Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 66, datë 28.04.2023, me arsyetimin se ankimi i paraqitur bazohet mbi të njëjtat fakte të shqyrtuara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, që janë vlerësuar drejt prej saj se nuk qëndrojnë.

3. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1531, datë 24.09.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit me arsyetimin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

4. Në datën 25.11.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

5.1.*E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë, në shkelje të rolit të saj kontrollues dhe subsidiar, nuk është shprehur për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese. Ajo e ka

shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore, duke i mohuar kërkuessit edhe të drejtën për t'u mbrojtur. Gjyqtarja e çështjes në GJKKO-në e Shkallës së Parë, në mënyrë të kundërligjshme, e ka zhvilluar seancën në dhomën e këshillimit në datën 13.03.2023, duke zbatuar ligjin nr. 41/2023, datë 23.03.2023 që ende nuk kishte hyrë në fuqi.

5.2. *Parimi i paanshmërisë*, pasi gjykatat e faktit kanë vlerësuar vetëm shkresat e të kallëzuarit, duke u treguar të njëanshme.

5.3. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në kundërshtim me ligjin, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në dhomën e këshillimit, duke mos i dhënë kërkuessit mundësinë të debatojë për provat.

5.4. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vetëm Gjykata e Lartë nuk ka dhënë në asnjë rresht të vendimit të saj përgjigje për pretendimet e kërkuessit. Të tria gjykatat nuk kanë analizuar faktet dhe provat e kërkuessit, duke mos u dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura në ankimet e tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen

me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal, i përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit, që ka vendosur për ligjshmërinë e vendimit të Prokurorisë së Posaçme për mosfillimin e procedimit penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës së një prokurori, të kallëzuar nga ai, me pretendimin se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, por pa përcaktuar ndonjë të drejtë substanciale të tij që lidhej drejtpërdrejt me këtë proces. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se neni 148, pika 1, i Kushtetutës parashikon se prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë.

10. Referuar sa më sipër, Kolegji konstaton se procedimi penal ka në objektin e tij të hetimit veprën penale të shpërdorimit të detyrës, e cila sipas ligjit procedural penal ndiqet kryesisht nga organi i prokurorisë, pa pasur nevojën e kërkesës apo ankimit të viktimës së veprës penale, sepse në thelbin e saj ajo sjell pasojat ndaj interesave dhe autoritetit shtetëror, arsye për të cilën ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në emër të shtetit kryhet vetëm prej prokurorit. Për këtë arsye, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individi kallëzues, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa justifikuar ai interesin individual, të drejtpërdrejtë dhe real, pra pa treguar të drejtën substanciale që i është rrezikuar nga procedimi penal. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

11. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.